



Nr. 09 prot
Dt. 24/03/2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

VENDIM

Nr.4, datë 19/03/2021

PËR

**MIRATIMIN E AUTORIZIMIT “PËR SHKARKIMIN E UJËRAVE
TË NDOTURA PËR SISTEME ME AGLOMERAT MBI 2000 P.E”,
BASHKISË TROPOJË.**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë.

V E N D O S I:

1. Miratimin e autorizimit “Për shkarkimin e ujërave të ndotur”, Bashkisë Tropojë, me vendndodhje, fshati Valbonë, Bashkia Tropojë, Qarku Kukës, sipas këtyre koordinatave:
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Pika e shkarkimit

- X=491407.426
- Y=4702095.692
- Z=922 m.m.n.d

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KBU DRIN-BUNË

MAJLINDA ANGONI

